VENDIM
Nr. 418, datë 26.6.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 321, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"; të pikave 1, shkronja "a", e 3, të nenit 70, të ligjit nr. 128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore", dhe të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, e vendimit nr. 321, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore", zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga buxheti i miratuar dhe nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1
Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

Nr.	Funksioni organik	Paga për funksion	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	*2*	*3*
1	Ndihmës specialist (vëzhgues/mbikëqyrës) në trupën operacionale	67,000	15,000
2	Ndihmës specialist (përpunues informacioni) në kartotekë	67,000	10,000
3	Specialist në drejtoritë rajonale	85,000	15,000
4	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme	91,000	12,000
5	Specialist për vlerësimin kalimtar dhe periodik (VETING-un)	91,000	20,000
6	Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale	95,000	17,000
7	Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme	110,000	15,000
8	Përgjegjës sektori për vlerësimin kalimtar dhe periodik (VETING-un)	110,000	20,000
9	Titullar i drejtorisë rajonale.	110,000	20,000
10	Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme	130,000	17,000
11	Këshilltar i drejtorit të përgjithshëm	130,000	0
12	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	150,000	22,000
13	Drejtor i përgjithshëm	170,000	30,000